



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 02.10.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 12:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
2. **Medi Bici** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Brunilda Kadi** (anëtare)
5. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
6. **Illir Toska** (anëtar)
7. **Alban Toro** (anëtar)
8. **Brikena Ukperaj** (anëtar)
9. **Erjon Muharremaj** (anëtar)
10. **Marçela Shehu** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zonja *Naureda Llagami*, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 10. Ermira Lleshi, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 11. Gregor Borgowski, EURALIUS.*
- 12. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
- 13. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 14. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 15. Armand Sokoli, Komisioni Shqiptar i Helsinkit.*
- 16. Sara K., Qendra Europiane.*
- 17. Tahim Lamçe, OSCE.*
- 18. Përfaqësues të medias (prezent vetëm në këtë pikë).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e juristëve

të spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Maksim Qoku: Atëherë, përshëndetje të gjithëve!

Vazhdojmë sot me mbledhjen e radhës, me një rend dite ndërtuar në dy pika.

Së pari, kemi shqyrtimin e projektvendimeve për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar. Natyrisht ne kemi përfunduar një verifikim serioz të thelluar të figurës dhe pasurisë dhe kritereve ligjore për secilin prej kandidatëve dhe në fakt, kjo është një risi e ligjit për Statusin e gjyqtarëve, pasi garanton në praktikë profesionalizëm, integritetin dhe garancitë e prurjeve në sistem.

Sot në fakt do të shqyrtohen projektvendimet për 20 kandidatë dhe për 8 kandidatët e tjerë, procesi i verifikimit do të kryhet në vijim. Përkatësisht do të shqyrtohen projektvendimet për kandidatët: {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...}; {...} dhe {...}.

Pika e dytë e rendit të ditës është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Edhe në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, siç jeni në dijeni, Këshilli më datën 11.09.2019 vendosi hapjen e garës edhe për një pozicion tjetër në Gjykatën e Lartë, nga juristët e spikatur. Në përfundim të afatit të aplikimit, pra që ka qenë afati i datës 26.09.2019, ka rezultuar që pranë Këshillit janë shprehur me interes kandidimi 6 kandidatë dhe aktualisht në fakt njëri është tërhequr nga kandidimi më datën 30.09.2019. Kështu që sot jemi në hapat e fundit drejt funksionalizimit të Gjykatës së Lartë, për pasojë, në ditët në vijim Këshilli do të përfundojë edhe procesin e përzgjedhjes së juristëve të spikatur, listë e cila do t'i përcillet presidentit për dekretim.

Kështu që, sipas rendit të ditës, procedojmë.

Nuk e di, kamerat?

Atëherë, kamerat ju lutem të dalin jashtë. Gazetarët mund të qëndrojnë brenda.

Ilir Toska: Atëherë, mendoj që këtë pikën e dytë ta shqyrtojmë si pikë të parë të rendit të ditës dhe pikën e parë ta shqyrtojmë si pikë të dytë, për shkak se në pikën e parë aktualisht, do duhet që ta bëjmë me dyer të mbyllura dhe do duhet të largohen të gjithë të pranishmit, përfshirë edhe gazetarët. Kështu që, kam propozimin, që të procedojmë fillimisht me pikën e dytë pra, për shqyrtimin e projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Pra kjo të jetë pika e parë.

Maksim Qoku: Okej! Në qoftë se të gjithë jemi dakord, mund të procedojmë me... Fjala për ju, zoti Toska!

Ju lutem, kamerat të largohen!

Gazetarët mund të qëndrojnë për pikën e parë të rendit të ditës, të cilën e parashtroi zoti Toska.

(Kameramanët largohen nga salla e mbledhjes.)

Atëherë, sipas asaj që vendosëm, procedoni zoti Toska, për pikën e parë të çështjes.

Ilir Toska: Mirë! Faleminderit!

Atëherë, për çështjen “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim, ndërkohë po ju parashtroj relacionin e këtij Komisioni lidhur me këtë projektvendim.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mbledhjen e datës 23 maj, miratoi vendimin nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, me anë të të cilit i hapej rrugë edhe procesit të përzgjedhjes së kandidatëve jogjyqtarë për emërim në Gjykatën e Lartë. Me anë të këtij

vendimi, përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të përzgjedhjes së kandidatëve nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë dhe caktimit të relatorit për secilin kandidat, proces ky që bëhet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, konkretisht nga “relatori” që është anëtar i këtij Komisioni dhe që caktohet me short.

Me vendimin nr.172, të datës 11.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor shpalli nisjen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, duke u bërë thirrje kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, në fushën e së drejtës civile. Sipas vendimit të mësipërm afati i kandidimit ishte dy javë nga momenti i publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pas përfundimit të këtij afati më datë 26 shtator 2019, u konstatuan se gjithsej kanë paraqitur kërkesë 6 kandidatë për në Gjykatën e Lartë, konkretisht: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe z. {...}. Mbështetur në Kreun V, seksioni “A”, pika 1 dhe 2 të vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, duhet që Këshilli brenda 7 ditëve nga përfundimi i afatit të kandidimit të nisë procedurën e verifikimit të kandidatëve, dhe në të njëjtën ditë të caktojë relatorin për secilin kandidat.

Duke iu referuar emrave të 6 kandidatëve konstatohet se vetëm kandidati {...} ka aplikuar rishtazi, ndërsa kandidatët znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, kanë aplikuar edhe për pozicionet shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019. Ndërkohë, kandidatja znj. {...}, është tërhequr nga kandidimi më datë 30.09.2019, pra pa filluar procedurat e verifikimit.

Nisur nga të dhënat sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë; caktimin e relatorit vetëm për kandidatin {...}; mosfillimin e procedurës së verifikimit për kandidaten znj. {...}, në kushtet e tërheqjes së saj nga kandidimi më datë 30.09.2019.

Ndërkohë për kandidatët znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë aplikuar edhe për pozicionet shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, Komisioni propozon që procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, të jenë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 172, datë

11.09.2019. Për këtë mbahet në konsideratë përcaktimi i bërë në pikën 7, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, ku përcaktohet se “Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”.

Lidhur me procedurën e caktimit të relatorit për kandidatin {...}, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës propozon që ajo të bëhet nëpërmjet procedurës së shortit si në rastet e tjera të ndjekura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke futur në një vazo qelqi, të palosura, shirita letre, me emrat e 3 anëtarëve të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës. Punonjësi i administratës të tërheqë një shirit letre nga vazoja në të cilën ndodhen emrat e anëtarëve të Komisionit, ta lexojë atë me zë të lartë dhe ky emër është pikërisht anëtari relator për ndjekjen e procedurës së verifikimit kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin, në këtë rast z. {...}.

Është edhe projektvendimi. Mund ta lexoj edhe projektvendimin. Ka këtë përmbajtje:

“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor - Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në pikat 1 dhe 2, Seksioni A, Kreu V dhe pikën 7, Seksioni B, Kreu VI, të vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, duke mbajtur parasysh kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, që kanë aplikuar brenda afatit të kandidimit (datë 26.09.2019) për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e tij nr. 172, datë 11.09.2019, faktin se disa nga kandidatët janë në proces e sipër verifikimi të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për pozicionet e shpallura me vendimet e tij nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, si dhe faktin që një prej kandidatëve është tërhequr nga kandidimi përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, vendosi: I. Fillimin e

procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur, që kanë aplikuar për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019. II. Caktimin e relatorit për kandidatin si më poshtë: {...}, relator ____ (do duhet të zhvillojmë shortin). III. Për kandidatët znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë aplikuar për pozicionet e shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019. IV. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, për kandidaten znj. {...}, në kushtet e tërheqjes së saj nga kandidimi më datë 30.09.2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

(Zoti Toska flet pa ndezur mikrofonin.)

Do duhet të zhvillojmë paraprakisht edhe procedurën e shortit për njërin nga kandidatët që ka aplikuar për pozicionin e lirë të shpallur. Faleminderit!

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, sipas asaj që parashtrroi zoti Toska, ju lutem administratës, të bëjë gati procedurën, duke bërë edhe kujdes që të mos zërë pamjen e gazetarëve.

Elis Kuçi: Atëherë, duke qenë se është vetëm një kandidat, do lexoj vetëm emrat e tre anëtarëve të Komisionit.

Zoti Alban Toro *(shiriti i letrës futet në enën e qelqit.)*

Zonja Marçela Shehu *(shiriti i letrës futet në enën e qelqit.)*

Zoti Ilir Toska *(shiriti i letrës futet në enën e qelqit.)*

(Shiriti i letrës tërhiqet nga një punonjës i administratës.)

Krisulla Kasaj: Alban Toro.

Maksim Qoku: Atëherë, në përfundim të shortit, relator për kandidatin {...} caktohet zoti Alban Toro. Kështu që, me shortin përfundojmë dhe trajtimin e çështjes së parë të rendit të ditës.

Po, zoti Toska!

Okej! Kalojmë në votim.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Pra përfunduar me çështjen e parë të rendit të ditës.

Administrata të marrë masat për publikimin e këtij vendimi.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor